



International Chamber of Commerce

*The world business organization*



Përgatitur nga Komisioni i ICC-së për

**Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-korrupsionin**

---

# **Rregullorja e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit**

Versioni anglisht © 2011, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), publikuar për herë të parë në vitin 1977. Përkthimi në shqip © 2017, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC). Përkthyer në shqip nga ICC Albania me lejen e ICC.

ICC zotëron të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale për këtë vepër të përbashkët dhe nxit riprodhimin dhe shpërndarjen e saj, sipas kushteve më poshtë:

- ICC-ja duhet të citohet si burimi dhe zotëruesja e së drejtës së autorit, duke përmendur titullin e dokumentit © Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) dhe vitin e publikimit nëse është e mundur.
- Duhet të merret leje e shprehur me shkrim për çdo ndryshim, përshtatje ose përkthim, për çdo përdorim tregtar dhe përdorim në ndonjë mënyrë që nënkupton se një organizatë ose person tjetër është burimi i veprës ose i lidhur me veprën.
- Vepra nuk mund të riprodhohet ose të vihet në dispozicion në faqet e internetit, përveç nëpërmjet një lidhjeje me faqen përkatëse të internetit të ICC-së (jo me vetë dokumentin).

Leja mund të kërkohet nga ICC-ja nëpërmjet adresës: [ipmanagement@iccwbo.org](mailto:ipmanagement@iccwbo.org).

**Tabela e Përmbajtjes**

<b>Parathënie .....</b>	<b>5</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>6</b>
<b>PJESA I</b>	
<b>Rregullat kundër korrupsionit .....</b>	<b>7</b>
Neni 1.....	7
<i>Praktikat e ndaluara</i>	
Neni 2.....	8
<i>Palët e Treta</i>	
<b>PJESA II</b>	
<b>Politikat e korporatës për të mbështetur përputhshmërinë me rregullat kundër korrupsionit .....</b>	<b>9</b>
Neni 3.....	9
<i>Partnerët e Biznesit</i>	
Neni 4.....	10
<i>Kontributet dhe sponsorizimet politike dhe për bamirësi</i>	
Neni 5.....	10
<i>Dhuratat dhe mikpritja</i>	
Neni 6.....	10
<i>Pagesat lehtësuese</i>	
Neni 7.....	11
<i>Konfliktet e interesit</i>	
Neni 8 .....	11
<i>Burimet njerëzore</i>	
Neni 9 .....	11
<i>Aspektet financiare dhe të kontabilitetit</i>	
<b>PJESA III</b>	
<b>Elementët e një Programi Efektiv të përputhshmërisë së Korporatës .....</b>	<b>13</b>
Neni 10.....	13
<i>Elementët e një Programi të Përputhshmërisë së Korporatës</i>	
<b>Shtojca A.....</b>	<b>15</b>
<i>Instrumentet Kryesore Ligjore Ndërkombëtare</i>	
<b>Shtojca B.....</b>	<b>16</b>
<i>Instrumente të tjera të ICC-së rreth Luftës kundër Korrupsionit</i>	
<b>Shtojca C.....</b>	<b>17</b>
<i>Komisioni i ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin</i>	
<b>Rreth ICC-së .....</b>	<b>18</b>

Struktura

Botimi i vitit 2011 i Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit përbëhet nga tre pjesë:

- **Pjesa I** përcakton Rregullat e duhura;
- **Pjesa II** trajton politikat që duhet të zbatohen Sipërmarrjet për të mbështetur përputhshmërinë me Rregulloren;
- **Pjesa III** rendit elementët e sugjeruar të një programi efikas të përputhshmërisë së korporatës.

## Parathënie

*Nga Jean-Guy Carrier, Sekretar i Përgjithshëm i ICC-së,  
François Vincke, Zëvendëskryetar i Komisionit të ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Antikorrupsionin, dhe  
Jean-Pierre Méan, Kryetar i Task Forcës për Rishikimin e Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit*

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) ka qenë gjithmonë pararojë e nxitjes për më tepër integritet në transaksionet e biznesit pasi vetëm një sistem pa korrupsion mundëson që të gjithë pjesëmarrësit të konkurrojnë mbi baza të barabarta.

ICC-ja thekson rolin e rëndësishëm të respektimit nga ana e Sipërmarrjeve të rregullave të vendosura prej tyre, duke pranuar në të njëjtën kohë përgjegjësinë bazë të organizatave ndërkombëtare dhe qeverive vendase në luftën kundër të gjitha praktikave korruptive, duke përfshirë zhvatjen, kërkimin me forcë dhe ryshfetin.

Respektimi nga ana e Sipërmarrjeve e rregullave strikte do t'i ndihmojë ato të përmbushin detyrimet e tyre ligjore në një mënyrë më të natyrshme, efikase dhe të qëndrueshme. Prandaj, rekomandohet fuqimisht miratimi dhe zbatimi i programeve të tyre të përputhshmërisë së korporatës nga bizneset, duke qenë se është kthyer në një detyrim për një numër të madh juridiksionesh.

ICC-ja është organizata e parë e biznesit që prezantoi botimin e rregullores kundër korrupsionit "Sjellja në Luftën kundër Zhvatjes dhe Ryshfetit", në fillim të vitit 1977. Ajo e ka përditësuar këtë Rregullore në vitin 1996, 1999 dhe 2005 për të reflektuar miratimin e instrumenteve kryesore ligjore ndërkombëtare, të tilla si Konventa për Luftën kundër Korrupsionit të Zyrtarëve të Huaj Publikë (1997) të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për Korrupsionin (2003). Këto instrumente, të cilat janë një gur i rëndësishëm themeli në luftën kundër korrupsionit, janë mbështetur në mënyrë aktive në miratimin, implementimin dhe zbatimin e tyre nga komuniteti i biznesit. ICC-ja do të vazhdojë të kontribuojë në mënyrë aktive në programet kundër korrupsionit të këtyre organizatave.

Rishikimi aktual i vitit 2011 i Rregullores së ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit pasqyron qartë zhvillimin mbresëlënës të praktikave të etikës dhe Përputhshmërisë së Sipërmarrjeve lider. Rishikimi bazohet në një numër të madh kontributesh të ofruara nga komitetet kombëtare të ICC-së, shoqëritë anëtare dhe ekspertët e Komisionit për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Antikorrupsionin. Ai ofron një model përputhshmërie të zbatueshëm për Sipërmarrjet e mëdha, të mesme dhe të vogla. Rishikimi mbështetet në dokumente të tjera që ICC-ja ka përgatitur, të tilla si Manuali i ICC-së "Lufta kundër Korrupsionit, një Manual i Praktikave të Korporatës" dhe Udhëzime të ndryshme të ICC-së për çështje specifike të integritetit.

Lufta kundër korrupsionit, e cila është në thelb të përgjegjshmërisë së korporatës dhe qeverisjes së mirë të korporatës, nuk ka përfunduar asnjëherë. Përpjekje të qëndrueshme do të vazhdojnë të jenë të nevojshme në të ardhmen. Nevojitet ndërgjegjësim më i mirë mes zyrtarëve publikë, në sallat e bordit dhe në të gjitha shtresat e botës korporative. ICC është e angazhuar që të vazhdojë të japë kontributin e saj për këtë detyrë të vështirë.

## Hyrje

Kjo Rregullore e ICC-së synon të shërbejë si një metodë vetërregullimi nga biznesi kundrejt legjislacionit vendas në fuqi dhe instrumenteve kryesore ligjore ndërkombëtare. Pranimi vullnetar i tyre nga Sipërmarrjet do të nxisë standarde të larta integriteti në transaksionet e biznesit, qoftë midis Sipërmarrjeve dhe organeve publike ose midis vetë Sipërmarrjeve. Kjo Rregullore luan rol të rëndësishëm për t'i ndihmuar Sipërmarrjet të përmbushin detyrimet e tyre ligjore dhe iniciativat e shumta kundër korrupsionit në nivel ndërkombëtar. Ajo gjithashtu siguron një bazë të duhur për t'i rezistuar përpjekjeve për zvatje ose kërkimin me forcë të rryshfeteve.

Kjo Rregullore është e një karakteri të përgjithshëm dhe përbën të ashtuquajturën praktikë të mirë tregtare. Ajo pasqyron dhe duhet të lexohet në përputhje me instrumentet kryesore ligjore ndërkombëtare të renditura në Shtojcën A.

Të gjitha Sipërmarrjet duhet të respektojnë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të vendeve në të cilat janë krijuar dhe ku operojnë, dhe duhet ta respektojnë këtë Rregullore siç shprehet dhe sipas synimit të saj.

Kontratat model të ICC-së përmbajnë referenca së Pjesës I të kësaj Rregulloreje. Sipërmarrjet gjithashtu nxiten të përfshijnë, plotësisht ose me anë të referencës, Pjesën I të kësaj Rregulloreje në kontratat e tyre tregtare, me qëllim parandalimin e cenimit të marrëdhënieve të tyre kontraktuale nga ndonjë formë e korrupsionit.

Sipërmarrjet këshillohen të bashkëpunojnë me njëra tjetrën, si dhe me iniciativa përkatëse ndërkombëtare, rajonale dhe sektoriale për të promovuar dhe zhvilluar praktikën e pasqyruara në këtë Rregullore; ato nxiten më tej të bashkëpunojnë me autoritete kombëtare dhe të huaja të zbatimit të ligjit që kryejnë hetime të lidhura me korrupsionin. Sipërmarrjet gjithashtu nxiten t'i bëjnë rezistencë zvatjes ose kërkimit me forcë të rryshfeteve, *për shembull*, me anë të përdorimit të instrumenteve të tilla si RESIST (Shih Shtojcën B).

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termi "Sipërmarrje" i referohet çdo personi ose subjekti të angazhuar në biznes dhe veprimtari të tjera ekonomike, i organizuar apo jo për qëllime fitimprurëse, duke përfshirë çdo njësi ekonomike të kontrolluar nga një shtet ose nëndarje territoriale të tij; ajo përfshin një shoqëri mëmë dhe shoqëritë e saj të kontrolluara. Megjithatë këto Rregulla nuk diferencohen sipas madhësisë së një Sipërmarrjeje ose karakterit të veprimtarive të saj, zbatimi i tyre do të duhet të përshtatet sipas një vlerësimi rreziku dhe kryesisht me karakterin e biznesit të ushtruar nga Sipërmarrjet e vogla dhe të mesme. Suksesi i kësaj Rregulloreje të ICC-së do të varet nga "qasja e strukturave drejtuese": duhet të ketë një mesazh të qartë nga Kryetari i Këshillit Drejtues (ose një organ tjetër me përgjegjësi të më të larta për Sipërmarrjen) dhe/ose Drejtori i Përgjithshëm i Sipërmarrjes se korrupsioni është i ndaluar dhe se do të zbatohet një program efikas i përputhshmërisë së korporatës. Aprovimi nga të gjithë punonjësit e Sipërmarrjes është gjithashtu thelbësor.

Kjo Rregullore e ICC-së përbëhet nga tre pjesë. Pjesa I përcakton Rregullat e duhura, Pjesa II trajton politikën që Sipërmarrjet duhet të miratojnë për të mbështetur përputhshmërinë me Rregulloren dhe Pjesa III rendit elementët e sugjeruar të një programi efikas të përputhshmërisë së korporatës. Shtojca A rendit instrumentet kryesore ligjore ndërkombëtare që trajtojnë korrupsionin. Shtojca B rendit instrumentet e ICC-së që do të jenë të dobishme për luftën kundër korrupsionit dhe Shtojca C risjell në vëmendje detyrat dhe rolin e Komisionit të ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionit.

## Pjesa I – Rregullat kundër korrupsionit

### Neni 1

#### Praktikat e ndaluara

Sipërmarrjet do të ndalojnë praktikat e mëposhtme në çdo kohë dhe formë në lidhje me

- një zyrtar publik në nivel ndërkombëtar, kombëtar ose vendor,
- një parti politike, zyrtar partiak ose kandidat për një post politik dhe drejtor,
- zyrtar ose punonjës të një Sipërmarrjeje,

pavarësisht nëse përfshirja në këto praktika është e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, duke përfshirë edhe nëpërmjet Palëve të Treta:

- a) **Ryshfeti** është oferta, premtimi, dhënia, autorizimi ose pranimi i çdo avantazhi të padrejtë financiar ose jo nga ose për çdo person të renditur më lart ose për çdo person tjetër, me qëllim marrjen ose mbajtjen e një biznesi ose avantazhi tjetër të pamërituar, *për shembull*, në lidhje me dhëniet e kontratave të prokurimit publik ose privat, lejet rregullatore, procedurat tatimore, doganore, gjyqësore dhe legjislative.

Ryshfeti shpesh përfshin (i) përqindjen e një pjese të pagesës së kontratës për zyrtarë qeveritarë ose partiakë ose për punonjës të Palës tjetër kontraktuese, të afërm të tyre të ngushtë, miq ose Partnerë Biznesi ose (ii) përdorimin e ndërmjetësve të tillë si agjentë, nënkontraktues, konsulentë ose Palë të tjera të Treta, për të kanalizuar pagesat te zyrtarët qeveritarë ose partiakë ose te punonjës të Palës tjetër kontraktuese, të afërm të tyre, miq ose Partnerë Biznesi.

- b) **Zhvatja ose kërkimi me forcë** është, në rast se kërkesa për ryshfet refuzohet, kërkimi i një ryshfeti, pavarësisht nëse shoqërohet apo jo me një kërcënim. Sipërmarrjet do të kundërshtojnë çdo tentativë për zhvatje ose kërkim me forcë dhe nxiten që t'i raportojnë këto tentativa nëpërmjet mekanizmave të disponueshëm formalë ose informalë të raportimit, përveçse nëse ky raportim konsiderohet si kundërproduktiv në raport me rrethanat.
- c) **Shfrytëzimi i ndikimit** është ofrimi ose kërkimi me forcë i një avantazhi të padrejtë, me qëllim ushtrimin e një ndikimi të pamërituar, real ose të supozuar me qëllim sigurimin nga një zyrtar publik të një avantazhi të padrejtë për nismëtarin e veprimit ose për çdo person tjetër.
- d) **Pastrimi i produkteve nga praktikat korruptive të lartpërmendura** është fshehja ose mbulimi i origjinës, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes ose pronësisë së paligjshme të pasurisë, me dijeninë se kjo pasuri është produkt i krimit.

“Korrupsion” ose “Praktika Korruptive”, siç përdoren në këtë Rregullore, përfshin ryshfetin, zhvatjen ose kërkimin me forcë, shfrytëzimin e ndikimit dhe pastrimin e produkteve nga këto praktika.

## **Neni 2**

### *Palët e Treta*

Në lidhje me Palët e Treta, objekt i kontrollit ose ndikimit përcaktues të Sipërmarrjes, duke përfshirë por pa u kufizuar me agjentët, konsulentët e zhvillimit të biznesit, përfaqësuesit e shitjeve, agjentët doganorë, konsulentët e përgjithshëm, rishitësit, nënkontraktuesit, franshizëmarrësit, avokatët, kontabilistët ose ndërmjetësit e ngjashëm që veprojnë në emër të Sipërmarrjes në lidhje me marketingun ose shitjet, negocimin e kontratave, marrjen e licencave, lejeve ose të autorizimeve të tjera ose veprime në interes të Sipërmarrjes ose si nënkontraktues në zinxhirin e furnizimit, Sipërmarrjet duhet:

- t'i udhëzojnë të mos përfshihen, as të tolerojnë që të përfshihen në ndonjë akt korrupsioni;
- të mos i përdorin si mënyrë për praktika korruptive;
- t'i punësojnë vetëm në masën e nevojshme për kryerjen e rregullt të biznesit të Sipërmarrjes dhe
- të mos i paguajnë më shumë sesa shpërblimi i duhur për shërbimet e tyre legjitime.



## **Pjesa II-Politikat e korporatës për të mbështetur përputhshmërinë me rregullat kundër korrupsionit**

### **Neni 3**

#### *Partnerët e Biznesit*

Partnerët e Biznesit përfshijnë (i) Palë të Treta dhe (ii) partnerë të sipërmarrjes së përbashkët dhe konsorciumit, si dhe kontraktues dhe furnizues.

- A. Në lidhje me një Palë të Tretë dhe në masën që është brenda kompetencës së saj, një Sipërmarrje duhet:
- të përcaktojë qartë se ajo pret që të gjitha veprimtaritë e kryera në emër të Sipërmarrjes të jenë në përputhje me politikat e saj; dhe
  - të lidhë një marrëveshje me shkrim me Palën e Tretë:
    - duke e informuar atë për politikat kundër korrupsionit të Sipërmarrjes dhe duke e angazhuar që të mos përfshihet në ndonjë praktikë korruptive;
    - duke e lejuar Sipërmarrjen të kërkojë auditim të librave dhe regjistrave të kontabilitetit të Palës së Tretë nga një auditues i pavarur për të verifikuar përputhshmërinë me këto Rregulla; dhe
    - duke parashikuar se shpërblimi i Palës së Tretë nuk do të paguhet në para cash dhe do të paguhet vetëm në (i) vendin e themelimit të Palës së Tretë, (ii) vendin ku ndodhen zyrat e saj qendrore, (iii) vendqëndrimin e saj ose (iv) vendin ku realizohet misioni.
- B. Sipërmarrja duhet të garantojë më tej se menaxhimi i saj qendror ka kontroll të mjaftueshëm mbi marrëdhënien me Palë të Treta dhe në veçanti mban të dhëna për emrat, afatet e angazhimit dhe pagesat për Palë të Treta të ruajtura nga Sipërmarrja në lidhje me transaksione me organe publike dhe Sipërmarrje shtetërore ose private. Ky regjistër duhet të vihet në dispozicion për inspektim nga auditues dhe autoritete qeveritare përkatëse të autorizuara sipas rregullave, në zbatim të kushteve të konfidencialitetit.
- C. Në lidhje me një Sipërmarrje të përbashkët (joint-ventures) ose konsorcium, Sipërmarrja duhet të marrë masa, brenda kompetencës së saj, për të garantuar se politika në pajtim me këto Rregulla është pranuar nga sipërmarrja e saj e përbashkët ose partnerët e konsorciumit, siç është e zbatueshme për sipërmarrjen e përbashkët ose konsorciumin.
- D. Në lidhje me kontraktuesit dhe furnizuesit, Sipërmarrja duhet të marrë masa brenda kompetencës së saj dhe në masën që është ligjrisht e mundur, për të garantuar se ata janë në përputhje me këtë Rregullore në transaksionet e tyre në emër të Sipërmarrjes ose me Sipërmarrjen dhe duhet të shmangë transaksionet me kontraktues dhe furnizues që njihen ose që në mënyrë të arsyeshme dyshohen se paguajnë rryshfete.
- E. Një Sipërmarrje duhet të përfshijë në kontratat e saj me Partnerë Biznesi një dispozitë që i jep asaj mundësinë të pezullojë ose përfundojë marrëdhënien, nëse ka një shqetësim të njëanshëm në mirëbesim se një Partner Biznesi ka vepruar në shkelje të ligjit të zbatueshëm kundër korrupsionit ose të Pjesës I të kësaj Rregulloreje.
- F. Një Sipërmarrje duhet të kryejë verifikimin e duhur paraprak për reputacionin dhe cilësinë e Partnerëve të Biznesit të ekspozuar ndaj rreziqeve të korrupsionit, për të qenë në përputhje me ligjin kundër korrupsionit në transaksionet e tyre me ose në emër të Sipërmarrjes.
- G. Një Sipërmarrje duhet t'i kryejë prokurimet e saj në përputhje me standardet e pranuar të biznesit dhe, për aq sa është e mundur, në një mënyrë transparente.

#### **Neni 4**

##### *Kontributet dhe sponsorizimet politike dhe për bamirësi*

- a) Sipërmarrjet duhet të japin kontribute për parti politike, zyrtarë dhe kandidatë partiakë vetëm në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm dhe njoftimit publik. Shuma dhe afati kohor i kontributeve politike duhet të rishikohen për të garantuar se ato nuk përdoren si mbulim për korrupsion.
- b) Sipërmarrjet duhet të marrin masa brenda kompetencave të tyre, për të garantuar se kontributet dhe sponsorizimet për bamirësi nuk përdoren si mbulim për korrupsion. Kontributet dhe sponsorizimet për bamirësi duhet të jenë transparente dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.
- c) Sipërmarrjet duhet të kryejnë kontrole dhe të hartojnë procedura të arsyeshme për të garantuar se nuk janë ofruar kontribute të pamërituara politike dhe për bamirësi. Duhet të ushtrohet kujdes i veçantë në rishikimin e kontributeve ndaj organizatave në të cilat janë përfshirë figura të shquara politike ose të afërm të tyre të ngushtë, miq dhe Partnerë Biznesi.

#### **Neni 5**

##### *Dhuratat dhe mikpritja*

Sipërmarrjet duhet të krijojnë procedura që mbulojnë ofertën ose pranimin e dhuratave dhe të mikpritjes, me qëllim garantimin që këto rregullime (a) janë në përputhje me legjislacionin vendas dhe instrumentet ndërkombëtare në fuqi; (b) kufizohen në shpenzime të arsyeshme dhe *në bona fide*; (c) nuk ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme, ose nuk konsiderohen se ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme pavarësinë e gjykimit të marrësit kundrejt dhënësit; (d) nuk bien ndesh me dispozitat e njohura të kodit të sjelljes së marrësit; dhe (e) nuk janë ofruar ose nuk janë marrë në periudha të shpeshta dhe as në një kohë të papërshtatshme.

#### **Neni 6**

##### *Pagesat lehtësuese*

Pagesat lehtësuese janë pagesa të vogla, të pamërituara, në mënyrë jozyrtare që i jepen një zyrtari të nivelit të ulët për të siguruar ose përshpejtuar realizimin e një veprimi rutinë ose të nevojshëm për të cilin pagesi i pagesës lehtësuese ka të drejtë ligjore.

Pagesat lehtësuese ndalohen në shumicën e juridiksioneve.

Si rrjedhojë, Sipërmarrjet nuk duhet të kryejnë pagesa lehtësuese por pranohet se ato mund të përballen me rrethana shtrënguese në të cilat kryerja e një pagese lehtësuese është shumë e vështirë që të shmanget, të tilla si rrethana kërcënuese ose kur rrezikohet shëndeti, siguria ose mbrojtja e punonjësve të Sipërmarrjes.

Kur një pagesë lehtësuese është kryer në këto rrethana, ajo do të justifikohet në mënyrë të saktë në librat dhe regjistrat e kontabilitetit të Sipërmarrjes.

## **Neni 7**

### *Konfliktet e interesit*

Konfliktet e interesit mund të lindin kur interesat private të një individi ose të të afërmeve të tij/të saj të ngushtë, miqve ose kontakteve të biznesit devijojnë nga ato të Sipërmarrjes ose organizatës së cilës i përket individi.

Këto situata duhet të bëhen të ditura dhe, kur është e mundur, duhet të shmangen pasi mund të cenojnë gjykimin e një individi në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij/të saj. Sipërmarrjet duhet të monitorojnë nga afër dhe të zgjidhin konfliktet reale ose të mundshme të interesit ose shfaqjen e tyre, të drejtorëve, zyrtarëve, punonjësve dhe agjentëve të tyre dhe nuk duhet të përfitojnë nga konfliktet e interesit të të tjerëve.

Nëse veprimtaria e tyre e parashikuar ose punësimi lidhen drejtpërdrejt me funksionet e mbajtura ose të mbikëqyrura gjatë qëndrimit të tyre në detyrë, ish zyrtarët publikë nuk duhet të punësohen ose përfshihen në ndonjë cilësi para se të ketë kaluar një periudhë e arsyeshme pas largimit të tyre nga detyra. Kur është e mundur, duhet të respektohen kufizimet e vendosura nga legjislati vendas.

## **Neni 8**

### *Burimet njerëzore*

Sipërmarrjet duhet të garantojnë se:

- a) praktikat e burimeve njerëzore, duke përfshirë marrjen në punë, ngritjen në detyrë, trajnimin, vlerësimin e performancës, shpërblimin, njohjen dhe etikën e biznesit në përgjithësi, reflektojnë këtë Rregullore;
- b) asnjë punonjës nuk do t'i nënshtrohet një veprimi disiplinor hakmarrjeje ose diskriminues për raportim në mirëbesim të shkeljeve ose shkeljeve kryesisht të dyshuara të politikës kundër korrupsionit të Sipërmarrjes ose për refuzimin për përfshirje në korrupsion, edhe nëse një refuzim i tillë mund të rezultojë në humbjen e biznesit të Sipërmarrjes;
- c) personeli kyç në fusha që janë objekt i një rreziku të lartë korrupsioni duhet të trajnohet dhe vlerësohet rregullisht; rotacioni i një personeli të tillë duhet të merret në konsideratë.

## **Neni 9**

### *Aspektet financiare dhe të kontabilitetit*

Sipërmarrjet duhet të garantojnë se:

- a) të gjitha transaksionet financiare janë identifikuar siç duhet dhe janë regjistruar në mënyrë të drejtë dhe të duhur në librat dhe regjistrat përkatës të kontabilitetit të vëna në dispozicion për inspektim nga Këshilli Drejtues ose një organ tjetër me përgjegjësitë më të larta për Sipërmarrjen, si dhe nga auditues;
- b) nuk ka llogari sekrete ose "të papërfshira në regjistrat tregtarë zyrtarë" dhe se nuk mund të lëshohen dokumente që nuk regjistrojnë në mënyrë të saktë dhe të drejtë transaksionet me të cilat lidhen;
- c) nuk ka regjistrim të shpenzimeve joekzistuese ose të detyrimeve me identifikim të pasaktë të objekteve të tyre ose transaksioneve të pazakonta që nuk kanë një qëllim të vërtetë legjitim;
- d) pagesat monetare ose pagesat në natyrë monitorohen, me qëllim shmangien e përdorimit të tyre si ryshfete; duhet të lejohen vetëm pagesat e vogla monetare të kryera nga shuma të vogla monetare ose në vende apo vendndodhje ku nuk ka sistem bankar funksional;
- e) asnjë dokument kontabël ose dokument tjetër përkatës nuk shkatërrohet qëllimisht më herët se sa kërkohet

me ligj;

- f) ekzistojnë sisteme të pavarura auditimi, qoftë nëpërmjet audituesve të brendshëm ose të jashtëm, të projektuara për të nxjerrë në pah transaksionet që bien ndesh me këtë Rregullore ose me rregullat e zbatueshme të kontabilitetit dhe që parashikojnë masa të përshtatshme korrigjuese nëse lind ndonjë problem;
- g) respektohen të gjitha dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve vendase tatimore, duke përfshirë ato që ndalojnë zbritjen e ndonjë forme pagese ryshfeti nga të ardhurat e tatueshme.

### **PJESA III- Elementët e një Programi Efektiv të përputhshmërisë së Korporatës.**

#### **Neni 10**

##### *Elementët e një Programi të përputhshmërisë së Korporatës.*

Çdo Sipërmarrje duhet të zbatojë një Program efektiv të përputhshmërisë së Korporatës (i) që reflekton këto Rregulla, (ii) që bazohet në rezultatet e një vlerësimi periodik të rreziqeve me të cilat përballet mjedisi i biznesit, (iii) që i përshtatet rrethanave specifike të Sipërmarrjes dhe (iv) që synon parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit dhe nxitjes së një kulture integriteti në Sipërmarrje.

Çdo Sipërmarrje duhet të shqyrtojë përfshirjen e të gjithave ose të një pjese të praktikave pozitive të mëposhtme në programin e saj. Në veçanti, ajo mund të zgjedhë, ndër pikat e renditura më poshtë, ato masa që i konsideron më të përshtatshme për të siguruar parandalimin e duhur kundër korrupsionit në rrethanat e saj specifike, ku asnjë masë e tillë nuk ka karakter të detyrueshëm:

- a) shprehja e mbështetjes dhe angazhimit të fuqishëm, të qartë dhe të dukshëm ndaj Programit të përputhshmërisë së Korporatës nga Bordi i Drejtorëve ose një organ tjetër me përgjegjësi vendimtare për Sipërmarrjen dhe nga këshilli i lartë drejtues i Sipërmarrjes (“qasja e strukturave drejtuese”);
- b) krijimi i një politike transparente dhe të shprehur qartë, e cila reflekton këto Rregulla dhe është detyruese për të gjithë drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe Palët e Treta dhe që zbatohet për të gjitha filialet e kontrolluara, të huaja dhe vendase;
- c) caktimi i detyrës Bordit të Drejtorëve ose një organi tjetër me përgjegjësi vendimtare për Sipërmarrjen, ose një komiteti përkatës të saj, për të kryer vlerësime periodike risku dhe rishikime të pavarura të përputhshmërisë me këtë Rregullore dhe për të rekomanduar masa ose politika korrigjuese, sipas nevojës. Kjo mund të realizohet si pjesë e një sistemi të zgjeruar të shqyrtimeve të përputhshmërisë së korporatës dhe/ose vlerësimeve të riskut;
- d) ngarkimi me përgjegjësi i individëve në të gjitha nivelet e Sipërmarrjes, për respektimin e politikës së Sipërmarrjes dhe për pjesëmarrjen në Programin e Përputhshmërisë së Korporatës;
- e) caktimi i një ose më shumë zyrtarëve të lartë (me kohë të plotë ose të pjesshme) për të mbikqyrur dhe koordinuar Programin e Përputhshmërisë së Korporatës me një nivel të mjaftueshëm burimesh, autoriteti dhe pavarësie, duke i raportuar periodikisht Bordit të Drejtorëve ose një organi tjetër me përgjegjësi vendimtare për Sipërmarrjen, ose komitetit përkatës të tyre;
- f) nxjerrja e udhëzimeve, sipas rastit, për të nxitur më tej sjelljen e duhur dhe për të frenuar sjelljen e ndaluar nga politikat dhe programi i Sipërmarrjes;
- g) ushtrimi i vigjilencës së duhur, në bazë të një qasjeje të strukturuar të menaxhimit të riskut, në përzgjedhjen e drejtorëve, zyrtarëve dhe punonjësve, si dhe të Partnerëve në Biznes, të cilët paraqesin rrezik korrupsioni ose shmangie të këtyre Rregullave;
- h) projektimi i procedurave financiare dhe të kontabilitetit për mbajtjen e librave të saktë dhe të duhur, dhe të të dhënave kontabël, për të siguruar se ato nuk mund të përdoren për qëllimin e përfshirjes në, ose fshehjes së praktikave korruptive;
- i) ngritja dhe ruajtja e sistemeve të duhura të procedurave të raportimit dhe kontrollit, duke përfshirë auditimin e pavarur;
- j) duke siguruar komunikim periodik të brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me politikën anti-korrupsion të Sipërmarrjes;
- k) udhëzimi dhe trajnimi i dokumentuar i drejtorëve, zyrtarëve, punëmarrësve dhe Partnerëve në Biznes, sipas rastit, për identifikimin e rreziqeve të korrupsionit në transaksionet e përditshme të biznesit të Sipërmarrjes,

si dhe trajnim lidershipi;

- l)** përfshirja e rishikimit të kompetencave të etikës së biznesit në vlerësimin dhe promovimin e drejtorëve dhe matja e arritjes së objektivave jo vetëm kundrejt treguesve financiarë, por edhe ndaj mënyrës sesi janë realizuar objektivat dhe specifikisht ndaj përputhshmërisë me politikën anti-korrupsion të Sipërmarrjes;
- m)** ofrimi i mënyrave për të ngritur problemet në fshehtësi të plotë, për të kërkuar konsulencë ose për të raportuar në mirëbesim ose shkelje të dyshuara në mënyrë të arsyeshme, pa frikën e hakmarrjes ose masës diskriminuese ose disiplinore. Raportimi mund të jetë ose i detyrueshëm, ose vullnetar; ai mund të kryhet në mënyrë anonime ose të hapur. Të gjitha raportimet në mirëbesim (*bona fide*) duhet të hetohen;
- n)** reagimi ndaj shkeljeve të raportuara ose të konstatuara, përmes marrjes së masës së përshtatshme korrigjuese dhe masave disiplinore dhe duke pasur parasysh kryerjen e njoftimit të duhur publik të zbatimit të politikës së Sipërmarrjes;
- o)** marrjen në konsideratë të përmirësimit të Programit të saj të Përputhshmërisë së Korporatës me anë të kërimit të certifikimit, verifikimit ose garancisë së jashtme; dhe
- p)** mbështetja e veprimit të përbashkët, si propozimi ose mbështetja e pakteve anti-korrupsion në lidhje me projekte specifike ose iniciativa afatgjata anti-korrupsion, me sektorin publik dhe/ose kolegët/partnerët në segmentet përkatëse të biznesit.

## **Instrumentet Kryesore Ligjore Ndërkombëtare**

### **Instrumentet Globale**

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)  
[http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transkombëtar (UNTOC)  
<http://www.unodc.org/documents/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCebook-e.pdf>
- Konventa e OECD mbi Ryshfetin për Zyrtarët të Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit (Konventa e OECD)  
<http://www.oecd.org/dataoecd/4/18/38028044.pdf>
- Rekomandimet e OECD për luftën e mëtejshme ndaj Ryshfetit për Zyrtarët e Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit, duke përfshirë Shtojcën II Udhëzim mbi Praktikat e mira për kontrollet e brendshme, Etikën dhe Përputhshmërinë.  
<http://www.oecd.org/dataoecd/11/40/44176910.pdf>

### **Afrika**

- Bashkimi Afrikan për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit (Konventa AU)  
[http://www.africa-union.org/official\\_documents/Treaties\\_%20Conventions\\_%20Protocols/Convention%20on%20Combating%20Corruption.pdf](http://www.africa-union.org/official_documents/Treaties_%20Conventions_%20Protocols/Convention%20on%20Combating%20Corruption.pdf)
- Protokollin i Zhvillimit të Komunitetit Afrikano-Jugor kundër Korrupsionit (Protokollin SADC)  
<http://www.sadc.int/index/browse/page/122>
- Komuniteti Ekonomik i Komunitetit të Shteteve Afrikano-Perëndimore në luftën kundër Korrupsionit (Protokollin ECOWAS)  
[http://www.afrimap.org/english/images/treaty/ECOWAS\\_Protocol\\_on\\_Corruption.pdf](http://www.afrimap.org/english/images/treaty/ECOWAS_Protocol_on_Corruption.pdf)

### **Amerika**

- Konventa Inter-Amerikane kundër Korrupsionit (Konventa OAS)  
<http://www.oas.org/juridico/english/treaties/b-58.html>

### **Azia dhe Rajoni i Paqësorit**

- Plani i Veprimit i ADB-OECD për Azinë-Paqësor (Plani i Veprimit)  
<http://www.oecd.org/dataoecd/38/24/35021642.pdf>

### **Europa**

- Konventa e Këshillit të Europës për të Drejtën Penale  
<http://conventions.coe.int/treaty/en/Treaties/Html/173.htm>
- Konventa e Këshillit të Europës për të Drejtën Civile  
<http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/174.htm>
- Rezoluta e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës: Marrëveshja për Krijimin e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit  
<http://conventions.coe.int/Treaty/EN/PartialAgr/Html/Greco9905.htm>
- Rezoluta e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës: Njëzetë Parime Udhëzuese për Luftën kundër Korrupsionit  
<https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?id=593789&>
- Konventa e Bashkimit Europian për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve dhe për Luftën kundër Korrupsionit dhe dy Protokolle përkatëse  
[http://europa.eu/legislation\\_summaries/fight\\_against\\_fraud/protecting\\_european\\_communitys\\_financial\\_interests/133019\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/fight_against_fraud/protecting_european_communitys_financial_interests/133019_en.htm)
- Konventa e Bashkimit Europian për Luftën kundër Korrupsionit duke përfshirë zyrtarë të Komuniteteve Europiane ose të shteteve Anëtare.  
[http://europa.eu/legislation\\_summaries/fight\\_against\\_fraud/fight\\_against\\_corruption/133027\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/fight_against_fraud/fight_against_corruption/133027_en.htm)

## **Shtojca B**

### **Instrumente të tjera të ICC-së rreth Luftës kundër Korrupsionit**

Për të siguruar udhëzime të mëtejshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje, Komisioni ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin ka publikuar botimin "Të luftosh Korrupsionin: Një Manual mbi Praktikën e Korporatës" (<http://store.iccwbo.org/fighting-corruption>).

Ky manual trajton çështje dhe fushat problematike që lidhen me luftën kundër korrupsionit, si vijon:

- Ndalimi i ryshfetit dhe zhvatjes: Zvogëlimi i fushave problematike (Kapitulli 3)
- Roli i agjentëve dhe ndërmjetësve të tjerë (Kapitulli 4)
- Përgjegjësitë e Sipërmarrjeve (Kapitulli 5)
- Kontabiliteti, Auditimi dhe Kontrolllet financiare (Kapitulli 6)
- Sinjalizimi (Kapitulli 7)
- Përputhshmëria e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (Kapitulli 8)
- Pastrimi i parave (Kapitulli 9)
- Kontributet Politike dhe Bamirëse (Kapitulli 10)
- Ryshfeti "Privat me Privat" (Kapitulli 11)
- Parandalimi i zhvatjes (Kapitulli 12)
- Tejkalimi i korrupsionit në Dogana (Kapitulli 13)

Komisioni i ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin zhvillon vazhdimisht mjete dhe udhëzime për anti-korrupsionin. Udhëzimet e mëposhtme janë në dispozicion në faqen e internetit të Komisionit të ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin (<http://www.iccwbo.org/About-ICC/Policy-Commissions/Corporate-Responsibility-Anti-corruption/>):

- Udhëzues i ICC-së për Sinjalizimin  
<http://www.iccwbo.org/advocacy-codes-and-rules/areas-of-work/corporate-responsibility-and-anti-corruption/whistleblowing/>
- Udhëzues i ICC-së për agjentët, ndërmjetësit dhe palët e treta  
<http://www.iccwbo.org/advocacy-codes-and-rules/areas-of-work/corporate-responsibility-and-anti-corruption/ICC-Third-Party-Guidelines/>

ICC, Global Compact i Kombeve të Bashkuara, Forumi Ekonomik Botëror dhe Transparency International kanë botuar RESIST, Të rezistosh ndaj Zhvatjes dhe Nxitjeve për Kërkesa në Transaksionet Ndërkombëtare, një mjet për Kompanitë në trajnimin e punonjësve (<http://www.iccwbo.org/products-and-services/fighting-commercial-crime/resist/>).



## **Shtojca C**

### ***Komisioni ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin***

Komisioni ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin është një organ global udhëheqës për sektorin privat i cili zhvillon rregulla për sjelljen, praktikat më të mira dhe avokon për luftën kundër korrupsionit dhe për përgjegjshmërinë e korporatës. Ky komision mbledh mbi 200 drejtues biznesi dhe ekspertë privat nga 40 vende.

ICC udhëheq mes organizatave të tjera të biznesit në denoncimin e korrupsionit dhe në zhvillimin e rregullave për të luftuar atë. Rregullorja e ICC-së për Luftën kundër Korrupsionit përbën themelin e punës së ICC-së për anti-korrupsionin, duke shërbyer edhe si një mjet për vetërregullim nga ana e biznesit dhe si një udhërrëfyes për qeveritë në përpjekjet e tyre për të luftuar zhvatjen dhe rryshfetin.

Përveç kësaj Rregulloreje, Komisioni i ICC-së për Përgjegjshmërinë e Korporatës dhe Anti-Korrupsionin ka zhvilluar një paketë mjetesh të rëndësishme rreth anti-korrupsionit për kompanitë që t'i përdorin në mënyrë proaktive, si pjesë e programeve të tyre të integritetit. Komisioni gjithashtu i ofron biznesit instrumente praktike për sjelljen e përgjegjshme të tyre.

ICC punon ngushtë me organizatat ndërqeveritare, të tilla si Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe OECD, të cilat janë të angazhuara në hartimin e ligjeve antirryshfet, udhëzimeve dhe politikave.

## Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)

ICC është organizata botërore e biznesit, organ përfaqësues që shprehet me autoritet në emër të sipërmarrjeve nga të gjithë sektorët, në çdo pjesë të botës.

Misioni themelor i ICC-së është promovimi i tregtisë së hapur dhe investimeve ndërkombëtare dhe asistimi i biznesit në përmbushjen e sfidave dhe mundësive të globalizimit. Bindja e saj se tregtia është një forcë e fuqishme për paqe dhe prosperitet daton që nga origjina e organizatës në fillim të shekullit 20-të. Grupi i vogël i liderëve largpamës të biznesit që themeluan ICC-në e quajtën veten "tregtarët e paqes".

ICC kryen tre aktivitete kryesore: përcaktimin e rregullave, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përkrahjen e politikave. Duke qenë se shoqëritë dhe shoqatat e saj anëtare janë të angazhuara vetë në biznesin ndërkombëtar, ICC ka autoritet të pakrahasueshëm në përcaktimin e rregullave që rregullojnë sjelljen e biznesit përtej kufijve. Edhe pse këto rregulla janë vullnetare, ato zbatohen çdo ditë në mijëra transaksione të panumërta dhe janë bërë pjesë e rrjetit të tregtisë ndërkombëtare.

ICC gjithashtu ofron shërbime shumë të rëndësishme, më kryesorja është Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit e ICC-së, institucioni më kryesor në botë për arbitrazh. Një tjetër shërbim është Federata e Dhomave Botërore, rrjeti botëror i ICC-së i dhomave të tregtisë, që nxit ndërveprimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira të dhomave të tregtisë. ICC gjithashtu ofron trajnime të specializuara dhe seminare dhe është botuesi kryesor i industrisë i materialeve praktike dhe edukative që merren si referencë nga biznesi ndërkombëtar, bankat dhe arbitrazhi.

Liderë dhe ekspertë biznesi të anëtarësuar në ICC shprehin këndvështrime të biznesit për çështje të gjera të politikave të investimeve dhe të tregtisë, si dhe për çështje përkatëse teknike. Këto përfshijnë ndër të tjera çështjet anti-korrupsion, bankare, mbi ekonominë digjitale, etikën e marketingut, mjedisin dhe energjinë, mbi politikat e konkurrencës dhe pronësinë intelektuale.

ICC punon ngushtë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Organizatën Botërore të Tregtisë dhe forumet ndërqeveritare, duke përfshirë G20.

ICC u themelua në 1919. Sot rrjeti i saj global përbëhet nga mbi 6 milionë shoqëri, dhoma tregtie dhe shoqata biznesi në më shumë se 120 shtete. Komitete kombëtare punojnë me anëtarët e ICC në shtetet e tyre për të trajtuar problematikat e tyre dhe për të përcjellë te qeveritë e tyre pikëpamjet e biznesit të formuluar nga ICC.

### INTERNATIONAL CHAMBER OF COMMERCE

33-43 avenue du Président Wilson, 75116 Paris, France

T +33 (0)1 49 53 28 28 F +33 (0)1 49 53 28 59

E [icc@iccwbo.org](mailto:icc@iccwbo.org)

[www.iccwbo.org](http://www.iccwbo.org)